



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PA1.nr.991/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS – Departamenti i përgjithshëm, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Shqipe Qerimi, kryetar i kolegjit, Hashim Çollaku dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Ahmeti, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit D.V., nga fshati ..., Komuna e Kaçanikut, për shkak të veprës penale vjedhje e pyllit në vazhdim, nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 81 të KPRK, duke vendosur sipas ankesës së të akuzuarit, të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.78/2019, të dt.10.08.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me 21.12.2020, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, ankesa e të akuzuarit D.V., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.78/2019, të dt.10.08.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik - Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.78/2019, të dt.10.08.2020, është shpallur fajtor i akuzuari D.V., për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim, nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 81 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 1(një)viti, i cili dënim do të ekzekutohet në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe dënimi me gjobë në shumë prej 1.000(njëmijë)Euro, të cilin dënim është obliguar që të paguaj në afat prej 30ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, në të kundërtën dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 50 ditëve, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20Euro.

Është obliguar i akuzuari që të paguajë shpenzimet e procedurës penale, sado që të jenë ato sipas llogarisë së bërë në arkë të gjykatës, paushallin gjyqësor në shumën prej 20 Euro, si dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, shumën prej 30Eurove, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Është obliguar i akuzuari që palës së dëmtuar t'ia kompensoj dënimin prej 2.124 Euro, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Kundër këtij aktgjykimi, në afat ligjor ankesë ka ushtruar i akuzuari D.V., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa e ushtruar të aprovohet si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje.

Prokuroria e Apelit, me shkresën, me shkrim PPA/II.nr.1004/2020, datë 21.10.2020, pas vlerësimit të ankesës së ushtruar, aktgjykimit të ankimuar, si dhe shkresave të tjera të lëndës, ka propozuar që ankesa e të akuzuarit D.V., të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Në kuptim të nenit 390 të KPPK, kolegji i kësaj gjykate ka caktuar seancën e kolegjit për dt.21.12.2020 dhe i ka njoftuar në mënyrë të rregullt të gjitha palët nga shkresat e lëndës. Nga shkresat e lëndës rezulton se në seancë të kolegjit ka prezantuar i akuzuari D.V., mbrojtësi i tij i caktuar nga kjo seancë e kolegjit, av.Abdurrahim Islami, ndërsa palët e tjera nuk kanë prezantuar përkundër asaj që janë njoftuar më rregull.

Gjykata e Apelit, pasi shqyrtoi shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioi aktgjykimin e ankimuar sipas ankesës së ushtruar, në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, gjeti se:

Ankesa e të akuzuarit D.V., nuk është e bazuar.

Sipas ankesës së të akuzuarit D.V., e cila në seancë të kolegjit është prezantuar nga ana e mbrojtësit Abdurrahim Islami, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat shkelje konsistojnë në kuptim të nënti 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK, duke theksuar se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme për çdo pikë të aktgjykimit dhe nuk ka arsyetuar se për çfarë arsye faktet konsiderohen të vërtetuara apo të pa vërtetuara, ashtu që të njëjtat menjëherë kanë ndikuar në marrjen e vendimit jo të drejtë. Gjykata e shkallës së parë, në këtë çështje penale besimin ia ka falur vetëm deklaratës së rojtarit të pyllit, të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit, L.M.. Gjithashtu, gjykata e shkallës së parë, nuk i ka aprovuar propozimet për të ftuar dëshmitarët e tjerë në seancë të kolegjit, ashtu që edhe aktgjykimi është i mangët dhe jo i drejtë.

Kolegji i kësaj gjykate, e ka shqyrtuar dhe vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sipas ankesës së të akuzuarit, si dhe shkresave të tjera të lëndës, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, në kuptim të nenit 384 të KPPK, për të cilat shkelje përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 394 të KPPK, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, nuk përfshihet në shkeljet e pretenduara dhe se dispozitivi i të njëjtit është i qartë, i kuptueshëm në harmoni me vetveten, si dhe me arsyetimin, ngase përmban faktet vendimtare përkitazi me veprën penale të vjedhjes së pyllit në vazhdim, nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 81 të KPK. Gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë ka vërtetuar elementet inkriminuese të veprës penale e cila i vihet në barrë të akuzuarit, sepse këto elemente janë të vërtetuara, gjatë procedimit dhe vlerësimit të provave personale, si dhe atyre materiale, të cilat rezultojnë nga shkresat e lëndës. Përkundër asaj që i akuzuarit, pretendon se nuk ka pre drunjte në pronën shoqërore, gjykata e shkallës së parë, ka vërtetuar se i akuzuari ka pre drunjte në pronën shoqërore dhe atë në rastin e parë me dt.24.10.2018, në vendin e ashtu quajtur “te Llageri”, në Parkun Kombëtar, e gjithashtu edhe në rastin e dytë të dt.26.10.2018, po të njëjtin vend, dhe pasi që ka vërtetuar sasinë e përgjithshme të drunjve të prerë, ka ardhur në përfundim se është kryer vepra penale e vjedhjes së pyllit në vazhdim. Gjithashtu, kolegji i kësaj gjykate erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë, aktgjykimin e nxjerr e ka punuar konformë dispozitës ligjore nga neni 370 të KPPK dhe se i njëjti përmban formën e kërkuar me shkrim, në të cilin rezulton se janë dhënë arsyet e mjaftueshme përkitazi me çdo veprim i cili i vihet në barrë të akuzuarit, se janë vërtetuar në mënyrë të padyshimtë të gjitha faktet të cilat e karakterizojnë veprën penale dhe se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të qartë ka paraqitur saktësinë e secilës provë, e cila ka qenë e rëndësishme për të vendosur çështjen penale, andaj, aktgjykimi gjykatës së shkallës së parë, ka mbështetjen e duhur ligjore.

Po ashtu i akuzuari aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, e ka ankuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, duke theksuar se gjendja faktike në këtë çështje penale nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, e kjo derivon nga shkresat e lëndës, sepse nga deklaratat e dëshmitarit M.V. - rojtarit të pyllit nuk mund të vërtetohet se ditën kritike i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Është e saktë nga deklaratat e të akuzuarit D.V., që natën kritike drunjte i ka gjetur të prera, dhe ai vetëm se ka marrë drunjte të prera më herët, degë, kurse ditën kritike nuk është e vërtetë se ka shkuar në pyll për të prerë dru, e kjo vërtetohet edhe nga vetë deklaratat e dëshmitarit – rojtarit të pyllit. Këto veprime i akuzuari i ka ndërmarrë duke theksuar se është i gjendjes së varfër ekonomike, ngase nuk është kryes i veprës, përkatësisht veprave penale, të cilat i vihen në barrë, andaj ka propozuar që në mungesë të provave të vlerësuara, çështja të kthehet në rigjykim.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar aktgjykimin e ankimuar, sipas pretendimeve ankimore, shkresat e tjera të lëndës dhe ka ardhur në përfundim se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka vendosur kur të akuzuarin D.V., e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale të vjedhjes së pyllit, nga neni 358 par.2 lidhur me nenin 81 të KPK, ngase me të gjitha provat nga shkresat e lëndës në mënyrë të pa dyshimtë vërtetohet se i akuzuari ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë. Kjo rezulton nga provat personale, përkatësisht deklaratat e rojtarit të pyllit L.M., i cili ka deklaruar se me dt.24.10.2018, i akuzuari D.V., ka shkuar për të prerë drunjë në pyllin shoqëror,

përkatësisht Parkun Kombëtar Sharri, njësia menagjuese Ahishta 1, në vendin e ashtuauqut “te Llageri”, dhe ka pre tri trungje të drurit të llojit të ahut, në vëllim të përgjithshëm prej 3.96m³, si dhe me dt.26.10.2018, po në të njëjtin vend ka prerë pesë trungje të llojit të ahut, në vëllim të përgjithshëm prej 3.08m³, kjo vërtetohet edhe nga provat materiale që janë pjesë përbërëse nga shkresat e lëndës. Nga fletëparaqitjet e rojtarit t pyllit me nr.146/2018, të dt.14.11.2018, raporti për fletëparaqitjen nr.48, i dt.24.10.2018, fletëparaqitja e rojtarit me nr.140/2018, të dt.14.11.2018,raporti me nr.41 i dt.26.10.2018, vërtetojnë se natën kritike i akuzuari, ka prerë drunjë pa pasur leje përkatëse në pyllin shoqëror në zonën e parkut kombëtar “Sharri”, zona menagjuese Ahishte 1, te vendi i ashtuquajtur “te llageri”, të cilat veprime i ka përshkruar L.M., kurse i akuzuari pavarësisht prej asaj që nuk ka pranuar që natën kritike ka prerë drunjë, por vetëm ka shkuar për të mbledhur degë, rrjedh se i njëjti natën kritike ka qenë në pyllin shoqëror me sharr motorrike të cilat prova gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar në mënyrë të duhur dhe ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë formuluar elementet qenësore të veprës penale të vjedhjes së pyllit në vazhdimësi, duke pasur parasysh që në harkun kohor prej dy ditëve, janë kryer këto dy vepra penale nga personi i njëjtë duke e dëmtuar, pronën shoqërore në pyllin “Parku Kombëtar Sharri”, atëherë gjykata e shkallës së parë drejtë ka vlerësuar dhe vendosur kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale të përshkruar sikurse në dispozitiv të aktgjykimit.

Kolegji i kësaj gjykate sipas detyrës zyrtare e ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sa i përket shkeljeve të ligjit penal, në kuptim të nenit 385 të KPPK dhe ka ardhur në përfundim se i njëjti nuk përfshihet me shkelje të parapara në këtë dispozitë ligjore, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka gjetur arsye që të akuzuarin ta përjashtojnë nga përgjegjësia penale dhe ndjekja penale, se në mënyrë të drejtë e ka aplikuar ligjin, i cili ka qenë i zbatueshëm në kohën e kryerjes së veprës penale, dhe se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka vendosur në kuadër të kompetencës ligjore.

Sipas ankesës së të akuzuarit, aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, është ankimuar për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke theksuar se në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë, të akuzuarit i ka shqiptuar dënim të ashpër, që rezulton se nuk i ka vlerësuar në masë të duhur rrethanat lehtësuese. Është evidente që i akuzuari në shqyrtim gjyqësor, ka pasur sjellje korrekte, se është i gjendjes së varfër ekonomik,, se është i pa punësuar dhe se kujdeset për nënën e tij të paralizuar. Gjithashtu thekson se është evidente që i akuzuari ka qenë recidivist në të kaluarën, por kjo për faktin se i njëjti është detyruar të ndërmarrë këto veprime, ngase për shkak të kushteve të rënda ekonomike, i është rrezikuar jeta familjes së tij, andaj, me dënimin e shqiptuar nuk do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit, por gjendja e të akuzuarit do të rëndohet edhe më shumë. Të gjitha këto rrethana gjykata e shkallës së parë, është dashur ti ketë parasysh dhe se shqiptimi i dënimit me burgim në kohëzgjatje prej 1 viti dhe i dënimit me gjobë në shumë prej 1.000Euro, janë jashtëzakonisht të rënda.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, ka vlerësuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ankesën e ushtruar, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar nuk përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit penal, se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë dhe të plotë ka vërtetuar gjendjen faktike, e

cila është vërtetuar nga provat e administruara, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe rrethanat lehtësuese, sikurse edhe ato rënduese, në kuptim të nenit 69 të KPPK, kurse si rrethana lehtësuese ka vlerësuar se i akuzuari është i gjendjes së varfër ekonomike, se nuk ka të ardhura, ashtu që është detyruar që ditën kritike të kryej këto vepra penale, se gjendja e këtij me këto dënime edhe më shumë do të rëndohet, e gjithashtu ka vlerësuar edhe rrethanat rënduese, e sidomos ka vlerësuar se i njëjti është përsëritës i veprave penale që vërtetohet nga aktgjykimi i formës së prerë të kësaj gjykate me numër P.nr.446/2015, të dt.04.09.2017, i formës së prerë me dt.05.10.2017, P.nr.226/2014, i dt.23.08.2016, i formës së prerë me dt.02.11.2016, P.nr.444/2015, i dt.04.09.2017, i formës së prerë nga t.05.10.2017, P.nr.129/2010, i dt.28.03.2018, i formës së prerë nga dt.21.05.2018, P.nr.626/2017, i dt.20.06.2019, i formës së prerë nga dtz.15.10.2019, e duke pasur parasysh edhe mënyrën e kryerjes së veprave penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave, kurse nga ankesa e të akuzuarit, nuk ka gjetur ndonjë rrethanën posaçërisht lehtësuese, andaj, në prani të këtyre rrethanave, kolegji është i bindur se me dënimin e shqiptuar do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij, që të parandalojë kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të paraparë në nenin 34 të KPPK-së (Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës).

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PA1.nr.991/2020, të datës 21.12.2021

Bashk. profesional,
Bujar Ahmeti

Anëtarët e kolegjit
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit
Shqipe Qerimi

Afrim Shala